



R KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 22.1.2020

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ANEKSIN VI TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE DETARE “PËR PARANDALIMIN E NDOTJEVE NGA ANIJET, 1973”, TË NDRYSHUAR ME PROTOKOLLIN E VITIT 1978 (MARPOL 73/78)””

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aneksin VI të Konventës Ndërkombëtare Detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973”, të ndryshuar me Protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)””, në mbledhjen e tij të datës 22 janar 2020.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Robert BITRI.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aneksin VI të Konventës Ndërkombëtare Detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973”, të ndryshuar me Protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)”” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji ka si qëllim aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aneksin VI të Konventës Ndërkombëtare Detare “MARPOL 73/78”.

Konventa MARPOL 73/78 është konventa më e rëndësishme në mbrojtjen e ujërave nga ndotjet që shkaktohen nga veprimtaria dhe incidentet e anijeve. Ajo ka 6 anekse dhe një protokoll, i cili u miratua pas një numri incidentesh në vitet 1976-1977. Konkretisht:

Aneksi I përmban rregulla për parandalimin e ndotjes nga karburanti;

Aneksi II përmban rregulla për kontrollin e ndotjes nga substanca të lëngshme helmuese në depozita;

Aneksi III përmban rregulla për parandalimin e ndotjes nga substanca të dëmshme që hidhen në det në formë paketimesh;

Aneksi IV përmban rregulla për parandalimin e ndotjes nga ujërat e zeza të anijeve;

Aneksi V përmban rregulla për parandalimin e ndotjes nga mbeturinat e anijeve;

Aneksi VI në të cilin synojmë të aderojmë me këtë projektligj përmban rregulla për parandalimin e ndotjes së ajrit nga anijet.

Republika e Shqipërisë ka aderuar që në vitin 2006 në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973” të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78) dhe pesë anekset e saj, ndërkohë që pas këtij aderimi Organizata Ndërkombëtare Detare miratoi edhe Aneksin VI, i cili parashikon rregulla për mbrojtjen e ajrit nga emetimi i gazeve nga djegia e karburanteve nga anijet.

Aderimi në këtë aneks të konventës synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotjet nga anijet. Ajo ka si objekt përmirësimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave të institucioneve zbatuese, si dhe të sigurojë standarde të njëjta për të gjitha shtetet anëtare lidhur me kërkesat për sigurinë e parandalimit të ndotjes së ajrit nga anijet.

Konkretisht Aneksi VI vendos limite për emetimin e oksidit të sulfurit dhe oksidit të nitrogjenit nga tubat e shkarkimit të anijeve, si dhe ndalon emetimet me qëllim të substancave të holluara të ozonit. Një kapitull i këtij aneksi i adoptuar në 2011-ën parashikon rregulla të detyrueshme për masa teknike dhe operative të efikasitetit të energjisë që synojnë reduktimin e emetimit të gazit serrë nga anijet. Sipas aneksit VI të rishikuar të konventës MARPOL, kufiri global i squfurit do të zvogëlohet nga 3.50% në 0.50%, dhe do të jetë efektiv nga 1 janari 2020, në varësi të një rishikimi të fizibilitetit që do të përfundojë jo më vonë se viti 2019.

Aktualisht, anijet me flamur shqiptar janë të detyruara të mbajnë certifikatat e përmendura në Aneksin VI, me anën e të cilave garantojnë se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e ajrit, pasi konventa i detyron të gjitha anijet që t'i plotësojnë këto kushte dhe të mbajnë këto certifikata. Nëse anijet shqiptare prekin porte detare të një shteti anëtar të Aneksit VI, administrata detare e këtij porti i inspekton për mbajtjen e këtyre certifikatave edhe anijet që mbajnë flamurin e një shteti jo anëtar. Mosekzistenca e këtyre certifikatave në bordin e anijes sjell si pasojë moslejimin e lundrimit të anijeve, si dhe i detyron pronarët e anijeve që të mirëmbajnë anijet, duke i plotësuar të

gjitha kushtet e nevojshme teknike sipas kërkesave të kërkuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare dhe Bashkimi Evropian.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përaftron ndonjë legjislacion të Bashkimit European.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Miratimi i këtij projektligji nuk do të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë shqyrtimit të projektligjit relatori i projektligjit u shpreh se aktualisht anijet me flamur shqiptar janë të detyruara të përmbushin kërkesat e aneksit VI për parandalimin e ndotjes së ajrit nga anijet, pavarësisht se ne nuk kemi aderuar akoma, dhe e të njëjtat kërkesa duhet të ketë edhe administrata detare shqiptare ndaj anijeve të huaja në ruajtje të bregut shqiptar nga ndotja dhe për këtë arsye aderimi në aneksin VI të Konventës MARPOL do të plotësojë më tej kuadrin ligjor shqiptar në fushën e parandalimit të ndotjes së ujërave nga anijet.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, shpjeguan elementët kryesorë të kësaj Konvente dhe Aneksit VI të saj , si dhe iu përgjigjën deputetëve në lidhje me projektligjin.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në:

- problemet me ndotjen të shkaktuar në brigjet shqiptare nga veprimtaria e transportit detar;
- mundësia për një kontroll më të mirë të anijëve në mënyrë që ndotja të mos jetë kaq e lartë;
- praktika e deritanishme e trajtimit të anijeve të huaja në lidhje me respektimin e dispozitave të Konventës MARPOL;
- kontrolli i karburanteve të përdorura nga anijet shqiptare dhe ndotja që shkakton, si dhe aspekte të tjera të Aneksit VI; etj.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive dhe përfitimeve që i vijnë vendit nga aderimi në këtë Aneks shtesë, duke qenë se aktualisht anijet me flamur shqiptar janë të detyruara të përmbushin kërkesat e Aneksit VI për parandalimin e ndotjes së ajrit nga anijet, pavarësisht se nuk kemi aderuar akoma.

Gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, Komisioni vendosi që në nenin 1 fjalët “Aderimin e Republikës së Shqipërisë aderon” të zëvendësohen me fjalët “Republika e Shqipërisë aderon”

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Robert BITRI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar